



Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës, nenin 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2024 dhe Plotësim ndryshim të UA 03/2024 për rregullimin e konkursit në sektorin publik, bazuar në Kodin e Punës së KEK-ut nr. 804 të datës 28.01.2025, si dhe nevojave emergjente të paraqitura për plotësimin e vendeve të lira të punës në Divizionin e Sherbimeve të Korporatës, UD Kryeshefi Ekzekutiv i KEK-ut më 08.05.2025 autorizon Drejtorin e Burimeve Njerëzore që të publikojë konkursin për pozitën e mëposhtme:

KONKURS

I. Titulli i pozitës:	<u>Rojtar</u>
Institucioni:	Korporata Energjetike e Kosovës
Numri i referencës:	07-08.05.2025
Tipi Akt Emërimit të punës:	Sipas Ligjit të punës 03/L-2012, UA01/2024, plotësim ndryshim të UA 03/2025 dhe Kodit të punës së KEK
Titulli i mbikëqyrësit:	I raporton udhëheqësit të ndërrimit për siguri fizike.
Kohëzgjatja e kontratës:	1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj.
Koeficienti-paga:	400.00Euro
Procedura e aplikimit:	I jashtëm
Numri i kërkuar:	300
Vendi i punës:	Korporata Energjetike e Kosovës (KEK sh.a.)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Monitorimi dhe kontrolli i Hyrje-Daljeve. Patrullimi dhe inspektimi i objekteve dhe hapësirave të KEK-ut. Reagimi ndaj incidenteve dhe emergjencave përfshirë lajmërimin për çdo sulm apo rrezik të cilin e parasheh apo e vëren, pra rreziqe të mundshme, si: vjedhje, dëmtim, sabotim apo ngjarje të tjera. Sigurimi i mjedisit të sigurt për stafin dhe vizitorët e KEK-ut.

- Pranimi dhe dorëzimi i detyrës bëhet në vendin e punës në tri ndërrime në orën 07:00, 15:00 dhe 23:00. Në rast të mosardhjes së ndërrimit vazhdohet deri te gjetja e zëvendësimit adekuat, e në rast të dështimit të zëvendësimit vazhdon edhe në ndërrimin vijues.
- Ta ketë të veshur çdoherë gjatë orarit të punës uniformën e caktuar për stafin e sigurisë fizike.
- Lexon raportin nga ndërrimi paraprak në librin e raportit të ndërrimit dhe gjatë ndërrimit evidenton të gjitha ngjarjet e rëndësishme që ndodhin, duke precizuar kohën e saktë të ngjarjes, llojin, vendin, veprimet e ndërmarra, etj.
- Kontrollon dhe verifikon se a janë në dispozicion dhe funksionale të gjitha pajisjet e nevojshme, si: radiolidhje, pranga, bateri ndriçimi, detektorë, kamera vëzhguese (nëse ka në pikë-rojën e tij), a është ndriçimi në nivel, etj.
- Në intervale të caktuara kohore (sipas urdhërësive të përcaktuara nga eprorët) klikon në sistemin e GPS-ve (në pikë-rojet ku ekzistojnë GPS-të) për të dëshmuar prezencën dhe vëzhgimin e hapësirave dhe objekteve.
- Ngjarjet e dyshimta që i vëren, përfshirë lëvizjet e dyshimta është i obliguar që menjëherë ta lajmërojë udhëheqësin e ndërrimit për siguri fizike, dhe sipas vlerësimit në rast nevojë edhe Policinë e Kosovës.
- Përpilon raportin e ngjarjeve në ndërrim dhe i raporton në fund të ndërrimit udhëheqësit të ndërrimit për siguri fizike.
- Verifikimi i identitetit të punonjësve, vizitorëve, kontraktorëve, etj që hyjnë në hapësirat dhe objektet e KEK-ut dhe mbajtja e regjistrit të hyrjeve-daljeve për palët e treta.
- Parandalimi i hyrjeve të paautorizuara dhe ndërmarrja e masave të duhura për të ndaluar persona të dyshimtë.
- Kryerja e patrullimeve të rregullta në ambientet e KEK-ut për të identifikuar rreziqe të mundshme.
- Sigurohet që dyert dhe dritaret e objekteve të jenë të mbyllura siç duhet.
- Ndërhyrja e menjëhershme në rast të situatave si: zjarri, vjedhja, dëmtimi apo akte tjera të vandalizmit.
- Përdorimi i pajisjeve të sigurisë dhe mjeteve kundër zjarrit për të shuar zjarret fillestare në zonën ku shërben.
- Sigurohet që askush nuk transporton pajisje ose materiale nga objektet dhe hapësirat e KEK-ut pa autorizim.
- Informimi i eprorëve të sigurisë fizike për çdo dobësi ose të metë që konstatohet e që mund të ndikojë apo ndërlidhet me sigurinë e objekteve dhe hapësirave.
- Koordinohet me ekipet e sigurisë për masa të përbashkëta parandaluese.
- Përgjigjet ndaj kërkesave të eprorëve dhe sigurohet që çdo situatë të trajtohet në përputhje me rregulloret e KEK-ut.
- Punonjësve që dalin para përfundimit të orarit të punës u kërkon leje-daljen e nënshkruar nga udhëheqësi i tyre.
- Sjellje profesionale dhe etikë e lartë pune.

Kërkesat profesionale/Kualifikimet

Certifikatë (licencë) e trajnimit themelor profesional për siguri fizike të lëshuar nga organi kompetent
Së paku shkollën fillore, e preferuar shkolla e mesme.
Aftësi të mira komunikuese dhe të punës ekipore.
Njohuri në përdorimin e sistemeve të monitorimit dhe kamerave të sigurisë.
Përgatitje e mirë fizike për të përballuar detyrat e patrullimit dhe ndërhyrjes në raste emergjente

Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit të tyre:

Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe te plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese: Aplikacionin e shkarkuar nga web faqja e KEK-ut e plotësoni, pas plotësimit duhet të ngarkohet në formën e aplikimit online te vegëza: "Ngarko Aplikacionin e plotësuar" vetëm formën tonë që gjendet në web faqen e KEK-ut.
Dëshmia për kualifikimin tuaj: Certifikatën (licencën) e trajnimit themelor profesional për siguri fizike të lëshuar nga organi kompetent, Diplomën (e shkollës fillore apo të mesme), i skanoni në një dokument të vetëm (formati .pdf ose .docx ose .doc, madhësia maksimale 5 MB), dhe pastaj e ngarkoni në aplikimin online te vegëza "Ngarko dëshmitë e kualifikimit". Nëse diploma është e fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës se fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është ne procedurë te nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në atë pozitë.

I. Titulli i pozitës:	<u>RECEPTIONIST/E</u>
Institucioni:	Korporata Energjetike e Kosovës
Numri i referencës:	07-08.05.2025
Tipi Akt Emërimit të punës:	Sipas Ligjit të punës 03/L-2012, UA01/2024, plotësim ndryshimit UA 03/2025 dhe Kodit të punës së KEK
Titulli i mbikëqyrësit:	I raporton udhëheqësit të sektorit për siguri fizike në DGJE.
Kohëzgjatja e kontratës:	1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj.
Koeficienti-paga:	450.00 Euro
Procedura e aplikimit:	I jashtëm
Numri i kërkuar:	1
Vendi i punës:	Korporata Energjetike e Kosovës (KEK sh.a.)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Mbikëqyrja e Hyrjes Kryesore (objekti i Drejtorisë Qendrore) për tu siguruar se punonjësit e KEK-ut dhe vizitorët (palët e treta) i respektojnë të gjitha procedurat për qasje në ndërtesë. Administrimin dhe menaxhimin e komunikimeve dhe pritjes së vizitorëve

- Sigurohet që të gjithë vizitorët të regjistrohen dhe të ndjekin protokollet e sigurisë së KEK-ut.
- Njofton paraprakisht zyrtarët e KEK-ut për ardhjen e vizitorëve.
- Verifikon identitetin e punonjësve, vizitorëve dhe kontraktorëve që hyjnë në objektin e KEK-ut në Toskanë.
- Trajton kërkesat për informacion ose ndihmë nga punonjësit dhe vizitorët.
- Sigurohet që zona e recepsionit të jetë e pastër, e organizuar dhe mikpritëse.
- Zbaton udhëzimet e menaxhmentit lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen e informacionit.
- Parandalon hyrjen në hapësirat e KEK-ut, të personave të paautorizuar dhe të dyshimtë.
- Sigurohet që kamerat e vëzhgimit të jenë funksionale dhe raporton për defektet teknike.
- Vëzhgon zonat kritike përmes kamerave të sigurisë dhe raporton çdo parregullsi.
- Mbikëqyrja e sjelljes së punonjësve dhe vizitorëve për të siguruar respektimin e rregullave të brendshme.
- Sigurohet që askush nuk transporton pajisje ose materiale nga objektet e KEK-ut pa autorizim.
- Raporton çdo sjellje të dyshimtë ose të rrezikshme tek udhëheqësit e sigurisë fizike.
- Plotëson raporte të detajuara në rast të paraqitjes së ndonjë problemi ose incidenti.
- Koordinohet me ekipin e sigurisë fizike për masa të përbashkëta parandaluese.
- Përgjigjet ndaj kërkesave të eprorëve dhe sigurohet që çdo situatë trajtohet në përputhje me rregulloret.
- Sigurohet që në ambientet e objektit të mos qëndrojnë persona pa leje ose arsye tjetër të vlefshme.
- Njofton policinë ose njësit e shërbimeve tjera për rastet e ndonjë emergjence.
- Ta ketë të veshur çdoherë gjatë orarit të punës uniformën e caktuar për stafin e sigurisë fizike.
- Bashkëpunon ngushtë dhe koordinon punët me punëtorin e sigurimit fizik me të njëjtin vendqëndrim.

Kërkesat profesionale/Kualifikimet

Diplomë e shkollës së mesme.
Certifikatë (licencë) e trajnimit themelor profesional për siguri fizike të lëshuar nga organi kompetent
Të ketë së paku 1 (një) vit përvojë pune në kuadër të shërbimit të sigurimit fizik

Njohuri në përdorimin e sistemeve të monitorimit me kamera të sigurisë.
Aftësi të mira komunikuese dhe të punës ekipore. Sjellje profesionale dhe etikë e lartë pune.
Aftësi për të përdorur pajisjet e sigurisë, si radio-komunikimi, alarmet dhe sistemet e mbikëqyrjes.
Njohuri bazike në gjuhën angleze
Njohuri bazike të MS Office (Word, Excel, etj.).

Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit të tyre:

Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe të plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese: Aplikacionin e shkarkuar nga web faja e KEK-ut e plotësoni, pas plotësimit duhet të ngarkohet në formën e aplikimit online të vegëza: "Ngarko Aplikacionin e plotësuar" vetëm formën tonë që gjendet në web faqen e KEK-ut.

Dëshmia për kualifikimin tuaj: Certifikatën (licencën) e trajnimit themelor profesional për siguri fizike të lëshuar nga organi kompetent, Diplomën e shkollës së mesme, Dëshminë e përvojës së punës me Kontratë ose Vërtetim mbi përvojën e punës, i skanoni në një dokument të vetëm (formati .pdf ose .docx ose .doc, madhësia maksimale 5 MB), dhe pastaj e ngarkoni në aplikimin online të vegëza "Ngarko dëshmitë e kualifikimit". Nëse diploma është e fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në atë pozitë.

Mënyra e aplikimit

Aplikimi është online, ngarkoni dokumentet sipas kërkesave në konkurs. Aplikimi juaj është i kompletuar vetëm nëse e merrni e-mailin konfirmues. Për çdo paqartësi dhe për siguri në aplikim kontaktoni në numrin e telefonit: 038 501-401-2671, 045/355111, por mund të shkruani edhe në e-mailin (ofertapune@kek-energy.com) për të vërtetuar aplikimin tuaj (vetëm nëse nuk keni pranuar e-mailin konfirmues).

Njoftimi me rezultatin e konkursit publik

Kandidatët do të njoftohen individualisht me rezultatin e këtij konkursi duke e respektuar Udhëzimin administrativ nr. 01/2024, plotësim ndryshimin e UA 03/2024 dhe Kodin e punës nr. 804 të datës 28.01.2025 për rregullimin e konkursit në sektorin publik.

Mënyra e vlerësimit të aplikantëve/kandidatëve:

Testi me shkrim vlerësohet deri shtatëdhjetë (70) pikë	
Jetëpërshkrimi (CV) deri dhjetë	(10) pikë
Intervista vlerësohet deri njezetë	(20) pikë

Në rast të pikëve të barabarta në fund të testimit (me gojë), përparësi do të kenë kandidatët nga komuna e Obilicës dhe zonat tjera të rrezikuara konform ligjit nr. 05/L-044.

Për më shumë informata për pozitën e lartpërmendur vizitoni web-faqen: **www.kek-energy.com**, ikona 'Shpallje' dhe mund ta shkarkoni aplikacionin për pozitën që aplikoni.

Vërejtje:

Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe të plota, duhet të keni kujdes si në vijim: **Nëse nuk e deklaroni që anëtar i familjes së ngushtë ju punon në KEK, në cilëndo fazë që vërtetohet, aplikacionet e juaja do të refuzohen. Aplikacionet pas afatit nuk do të pranohen, ndërsa ato të mangëta ose që nuk janë në formatin e kërkuar më lartë do të refuzohen.** Kandidati i suksesshëm do të sistemohet në pozitën për të cilën ka aplikuar sipas kësaj shpalljeje dhe në afatin prej 3 (tri) viteve nga dita e kontratës së parë nuk ka të drejtë ri-sistemimi në vend tjetër të punës.

Kalendari i përafërt: brenda 25 ditësh testi me shkrim, brenda 30 ditësh intervista me gojë dhe vlerësimi i CV-së. Njoftimi final brenda 50 ditësh nëse nuk ka ankese të cilat e pezullojnë afatin e paraparë sipas UA 01/2024, plotësim ndryshimit të UA 03/2024 dhe në bazë të Kodit të punës nr. 804 të datës 28.01.2025.

Data e aplikimit deri më 23.05.2025 ora 24:00
Prishtinë, 08.05.2025

Divizioni i Burimeve Njerëzore

